

Raport përfundimtar

Rregulla për Mekanizmin Mbështetës për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë

Përgjigje ndaj komenteve

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ana e ZRRE-së me qëllim të informimit të palëve të interesit. Raporti nuk paraqet vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të interpretohet si i tillë.

5 dhjetor 2025

Përmbajtja

1	Hyrje	2
2	Përmbledhje e procesit	2
3	Komentet e Palëve të Interesit	3
3.1	Komentet e Odës Ekonomike të Kosovës	3
3.2	Komentet e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT)	4
3.3	Komentet e Ministrisë së Ekonomisë.....	5
3.4	Komentet e pranura gjatë takimit konsultativ nga Ministria e Ekonomisë dhe KOSTT	5
4	Përgjigjet ndaj komenteve të palëve të interesit.....	5
4.1	Përgjigjet ndaj komenteve të Odës Ekonomike të Kosovës	5
4.1.1	Statusi ligjor, struktura qeverisëse e OER dhe raportet me ZRrE	6
4.1.2	Çmimi referent i kontratave për diferencë	6
4.1.3	Rezerva e likuiditetit.....	6
4.1.4	Detyrimi i Energjisë së Ripërtërishme	7
4.2	Përgjegjësitë balancuese për vetë-konsumatorët	7
4.2.1	Përfshirja e vetë-konsumatorëve në Mekanizmin Mbështetës.....	7
4.2.2	Baza ligjore për integrimin e vetë-konsumatorëve.....	8
4.2.3	Kompensimi për vetë-konsumatorët	9
4.2.3.1	Kompensimi në draftin ekzistues i vetë-konsumatorëve	9
4.2.3.2	Bartja e përgjegjësisë balancuese tek Furnizuesi i vetë-konsumatorit	10
4.3	Komentet e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT)	12
4.3.1	Kostot shtesë të KOSTT për menaxhimin e përgjegjësisë të OER.....	12
4.3.2	Sfidat operationale të menaxhimit të tepricave të energjisë	12
4.3.3	Viti Relevant dhe llogaritja e Fondit BRE.....	12
4.4	Komentet e Ministrisë së Ekonomisë (ME)	12
4.4.1	Qartësimi i kostove që ndërlidhen me skemat mbështetëse	12
4.4.2	Harmonizimi me Ligjin për BRE	13
4.4.3	Borxhi i keq i OER	13
4.4.4	Përfshirja e kostove të financimit apo financiare	13

1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) është në procesin e hartimit të Rregullit për Mekanizmin Mbështetës për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (Rregulla për Mekanizmin Mbështetës). Rregulla ofron mekanizëm transparent dhe të strukturuar për mbulimin e mbështetjes financiare që ofrohet me qëllim të nxitjes së investimeve në kapacitetet e energjisë së ripërtërishme, në përputhje me objektivat e Kosovës për energjinë e ripërtërishme. Rregulla për Mekanizmin Mbështetës është detyrim ligjor që buron nga Ligji Nr. 038/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (Ligji për BRE).

Ky Raport paraqet përmbledhjen e komenteve të pranuar nga palët e interesit dhe përgjigjet e ZRrE-së mbi to. Dokumenti është strukturuar si vijon:

- Kapitulli 2 ofron një përmbledhje të procesit të hartimit të Rregullës për Mekanizmin Mbështetës;
- Kapitulli 3 ofron një përmbledhje të komenteve të ofruara nga palët e interesit;
- Kapitulli 4 ofron përgjigjet e ZRrE-së ndaj komenteve të pranuar.

Rregulla e ndryshuar, që reflekton komentet e pranuar, do të publikohet në ueb-faqen e ZRrE-së së bashku me këtë Raport.


2 Përmbledhje e procesit

Ky kapitull i Raportit përmbledhë procesin e hartimit të Rregullës për Mekanizmin Mbështetës për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë.

- Më 3 korrik 2025, me përkrahjen teknike të ofruar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), ZRrE ka filluar hartimin e Koncept Dokumentit për Rregullën për Mekanizmin Mbështetës.
- Më 18 gusht 2025, ZRrE ka publikuar Koncept Dokumentin për Mekanizmin Mbështetës me qëllim ndërtimit të një diskutimi konceptual për rolet dhe përgjegjësitë e Operatorit për Energjinë e Ripërtërishme (OER). Gjatë periudhës së konsultimit publik, ZRrE ka pranuar komente nga Shoqata e Bankave të Kosovës (ShBK), Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX) dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT).
- Më 15 shtator 2025, ZRrE ka organizuar një tryezë si platformë diskutimi për të prezantuar konceptin dhe dëgjuar sugjerimit e palëve të interesit. Tryeza mbledhi 48 pjesëmarrës nga 19 organizata, duke përfshirë oda ekonomike, institucione financiare dhe akterë të sektorit të energjisë.
- Më 6 nëntor 2025, ZRrE ka publikuar draft Rregullën për Mekanizmin Mbështetës me qëllim të konsultimit të palëve të interesit. Drafti i publikuar nga ZRrE ishte bazuar në Koncept Dokumentin për Rregullën për Mekanizmin Mbështetës dhe komenteve të palëve të interesit mbi këtë koncept dokument.

- Më 02 dhjetor 2025, ZRrE ka marrë pjesë në takim me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe KOSTT, me qëllim të sqarimit të komenteve të pranuar nga palët. Gjatë këtij takimi palët kanë ofruar komente shtesë të cilat janë përfshirë në këtë dokument.

Figure 1 Procesi i hartimit të Rregullës për Mekanizmin Mbështetës



Dokumente të tjera relevante që ndërlidhen direkt me përmbajtjen e këtij Raporti.

Ligji për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë <https://tinyurl.com/52xfnarv>

Rregulla për vet-konsumatorët me Burime të Ripërtërishme <https://tinyurl.com/bddfbcfsf>

Koncept Dokumenti për Mekanizmin Mbështetës për BRE-të <https://tinyurl.com/53syv6jk>

Draft Rregulla për Mekanizmin Mbështetës për BRE-të <https://tinyurl.com/4xfaz8r>

3 Komentet e Palëve të Interesit

Ky kapitull i Raportit ofron një përmbledhje të komenteve të palëve të interesit, të radhitura sipas kronologjisë së pranimit të këtyre komenteve.

- Kapitulli 3.1 ofron komentet e Odës Ekonomike të Kosovës;
- Kapitulli 3.2 ofron komentet e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT);
- Kapitulli 3.3 ofron komentet e Ministrisë së Ekonomisë.

3.1 Komentet e Odës Ekonomike të Kosovës

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) e vlerëson Rregullën e propozuar si një hap thelbësor drejt operacionalizimit të Ligjit Nr. 08/L-258 për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë. Kjo Rregull krijon bazën institucionale dhe financiare për mbështetjen e prodhuesve të energjisë përmes Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme. OEK thekson se Rregulla është në harmoni me praktikat e

Bashkimit Evropian dhe ofron instrumente mbështetëse moderne si Kontrata për Diferencë (CfD) dhe Premium (FiP). Megjithatë, sipas OEK:

- Nuk është plotësisht i qartë statusi ligjor i Fondit mbështetës dhe marrëdhëniet e Fondit me ZRrE-në dhe Operatorin e Tregut. Në shtetet fqinje si Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut, operatori homolog është entitet i veçantë ose nën administrimin e OST-së, me llogari të ndara dhe me mbikëqyrje të drejtpërdrejtë nga Rregullatori. Rrjedhimisht OEK rekomandon qartësimin e statusit ligjor dhe strukturës qeverisëse të OER për të shmangur konfliktet e interesit.
- Mekanizmat Mbështetës si CfD dhe FiP janë të mirëseardhur por çmimet referente të referencuara në këto skema duhet të bazohen në burime të qarta si çmimet e tregut në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX) apo zyrën ekuivalente të saj në Serbi (SEEPEX) derisa Kosova të krijojë plotësisht tregun e vet të organizuar. Rezerva e likuiditetit duhet të ndërtohet në një periudhë afatgjate dhe pasqyrat financiare duhet të auditohen.
- Rezerva e likuiditetit i tejkalon vlerat e shteteve në rajon, posaçërisht Shqipërisë dhe Maqedonisë, të cilat kanë paraqitur vlera më të ulëta të likuiditetit. Po ashtu, niveli i likuiditetit duhet të arrihet në një periudhë tranzitore për të shmangur rritjen e menjëhershëm të Detyrimit për Energjinë e Ripërtërishme.
- Para aplikimit të Detyrimit për Energjinë e Ripërtërishme duhet të sigurohemi që të funksionalizohet sistemi i Garancive të Origjinës për të shmangur abuzime dhe vështirësi në verifikim. Ndikimi i tarifës në konsumatorët në nevojë duhet të analizohet dhe të konsiderohen mekanizmat kompensues.

Në fund të dokumentit OEK ofron një përmbledhje të krahasimit të propozimit të ZRrE-së me praktikatat rajonale në Shqipëri e Maqedoni të Veriut dhe një sërë rekomandimesh që i plotësojnë komentet e përshkruara më lart.

3.2 Komentet e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT)

Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe tregut (KOSTT) vlerëson se rregulli paraqet paqartësi operacionale, rreziqe financiare dhe është në konflikt me Ligjin për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE). Komenti kryesor i KOSTT-it lidhet me propozimin që Operatori i Energjisë së Ripërtërishme (OER) të jetë Pala Përgjegjëse Balancuese (BRP) për energjinë e tepërt të injektuar në rrjet nga vetë-konsumatorët. KOSTT thekson se vetë-konsumatorët duhet të nënshkruajnë kontratë me furnizuesin e tyre, në pajtim me Nenin 28, paragrafin 2.5 të Ligjit BRE. Sipas KOSTT-it, Ligji implikon që vetë-konsumatorët duhet të jenë pjesë e grupit balancues të Furnizuesit të tyre, dhe kompensimi duhet të bëhet përmes Furnizuesve.

KOSTT parashtrohet pasoja të dëmshme që do të lindnin nëse OER-i caktohet si BRP për energjinë e tepërt të vetë-konsumatorëve. Këto përfshijnë, në mes tjerash, kufizimin ose ndalimin e kontratave bilaterale ndërmjet vetë-konsumatorëve dhe Furnizuesve, duke kufizuar kështu zhvillimin e tregut; shndërrimin e OER-it në një "blerës të vetëm" (*single buyer*), gjë që kufizon konkurrencën dhe rrit joefikasitetin. Sipas KOSTT, ky detyrim i ekspozon financiarisht ata duke rrezikuar operimin e kompanisë, rritur kostot administrative (e me këtë rritjen e tarifave), dhe implikon kërkesa të reja për shërbimet e teknologjisë informative në KOSTT.

Për më tepër, KOSTT ngre shqetësime lidhur me Fondin për BRE-të. KOSTT propozon ndryshimin e Neni 8.1, që kërkon që të ardhurat nga Tarifa e Detyrimit të Energjisë së Ripërtërishme (DER) të jenë *të barabarta* me Fondin e miratuar, duke kërkuar që ato të jenë *"sa më afër që është e mundshme të barabarta"*. KOSTT po ashtu kërkon qartësimin e definicionit të "Viti Relevant" dhe shprehet se rregulla mbi ndarjen e informacionit të ndjeshëm komercial mes OER dhe Operatorit të Tregut (Neni 7) nuk është e mundshme të zbatohet.

3.3 Komentet e Ministrisë së Ekonomisë

Ministria e Ekonomisë (ME) potencon nevojën për harmonizim të rregullës me legjislacionin ekzistues dhe qartësimin e përgjegjësiwe operacionale të OER. Në lidhje me Nenin 5 të Rregullës, Ministria kërkon që furnizuesit të jenë përgjegjës për balancimin e vetë-konsumatorëve, në përputhje me Nenin 30 të Ligjit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë. Gjithashtu, lidhur me të ardhurat e Fondit, Ministria propozon harmonizimin e Nenin 12, Paragrafi 1.3 me Nenin 3, Paragrafin 1.39 të Ligjit për Burimet e Ripërtërishme.

Për Nenin 11, paragrafi 1.9, i cili i referohet "kostove që lidhen me financimin e çdo kostoje shtesë të skemës mbështetëse", ME thekson se formulimi është i paqartë dhe sugjeron dhënien e shembujve të kategorive të shpenzimeve që mund të mbulohen, edhe nëse lista nuk është shteruese. Lidhur me "borxhin e keq të lejuar" Ministria thekson se është e paqartë se cilat janë shkaqet që konsiderohen të pranueshme për krijimin e këtij borxhi të keq, dhe kërkohet sqarimi i tyre.

3.4 Komentet e pranuar gjatë takimit konsultativ nga Ministria e Ekonomisë dhe KOSTT

Ministria e Ekonomisë dhe KOSTT në takimin e datës 2 dhjetor 2025 vejnë theksin në nevojën për sqarim të bazës ligjore për kompensim të Vetë-Konsumatorëve të pranuar në skemat mbështetëse për vetë-konsum. Gjithashtu, është kërkuar që të sqarohet se për cilët vetë-konsumatorë vlen kompensimi i furnizuesve nga OER. Si dhe të shtjellohet se pse merret për bazë ALPEX në kalkulimin e kompensimit.

Ministria e Ekonomisë kërkoi që pika 2 e Nenit 15, të Rregullës të ndryshohet nga *"... ose instrumenteve të tjera të financimit"*, në *"... ose instrumenteve të tjera financiare"*.

4 Përgjigjet ndaj komenteve të palëve të interesit

Ky kapitull i Raportit paraqet përgjigjet e ZRrE-së ndaj komenteve të palëve të interesit.

- Komentet e Odës Ekonomike të Kosovës do të adresohen në Kapitullin 4.1;
- Komentet e KOSTT dhe ME lidhur me përgjegjësitë e balancimit dhe ndryshimet e nevojshme në skemën mbështetëse të vetë-konsumatorëve trajtohen së bashku në Kapitullin 4.2;
- Komentet e tjera të KOSTT dhe ME adresohen në Kapitujt 4.3, respektivisht 4.4;

4.1 Përgjigjet ndaj komenteve të Odës Ekonomike të Kosovës

ZRrE vlerëson angazhimin konstruktiv të komunitetit të biznesit në politikë bërjen e saj dhe kontributin e tyre në përmirësimin e këtyre politikave.

4.1.1 Statusi ligjor, struktura qeverisëse e OER dhe raportet me ZRrE

Lidhur me komentimin për kornizën ligjore dhe përgjegjësitë e OER, ZRrE thekson sqarimin e ofruar në Kapitullin 4.1 të Koncept Dokumentit për Mekanizmin Mbështetës për Energjinë e Ripërtërishme¹. Krijimi dhe funksionimi i OER-it si palë homologe e prodhuesve të energjisë së ripërtërishme që marrin mbështetje, si dhe menaxhimi i Fondit për BRE, mbështeten në dispozitat e Ligjit për BRE dhe rregullohen legjislacioni sekondar dhe Rregullat e Tregut të miratuara nga ZRrE-ja. Në koordinim me ZRrE-në, Ministria e Ekonomisë propozoi që funksionet e OER-it t'i transferohen një entiteti ekzistues, dhe Qeveria me Vendimin Nr. 08/236 caktoi KOSTT-in që t'i ushtrojë këto funksione nën licencën e tij të Operatorit të Tregut. KOSTT, si ndërmarrje publike nën mbikëqyrjen e Kuvendit, ka administruar Fondin BRE që nga viti 2017.

Në ushtrimin e funksioneve të OER-it, KOSTT do të operojë nën kornizën e rregullimit ekonomik të ZRrE-së, në përputhje me Nenet 60 dhe 61 të Ligjit për BRE dhe Nenet 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, të cilat i japin ZRrE-së mandat për monitorim dhe mbikëqyrje ndaj subjekteve të licencuara. ZRrE-ja e gëzon të drejtën e auditimit të plotë financiar, kontraktual dhe operacional për aktivitetet e OER-it që lidhen me zbatimin e skemave mbështetëse, në pajtim me legjislacionin përkatës, Rregullin për Mekanizmin Mbështetës si dhe Udhëzimet Rregullatore për Kontabilitet.

4.1.2 Çmimi referent i kontratave për diferencë

ZRrE pajtohet me propozimin e OEK që çmimet referente të kontratave të mbështetjes të mbështeten në tregjet e ditës në avancë me nivel më të lartë likuiditeti. Propozimi i OEK është në linjë me atë të ZRrE-së që për bazë të merret çmimi referent i tregut të ditës në avancë i Bursës Kombëtare të Energjisë (ALPEX). ZRrE nuk pajtohet me propozimin e OEK që si referencë të merret edhe bursa e Serbisë SEEPEX, pavarësisht nivelit më të lartë të likuiditetit, për arsye të bllokimit të alokimit komercial të linjave ndër-kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë.

4.1.3 Rezerva e likuiditetit

ZRrE pajtohet me vlerësimin e OEK se rezerva e likuiditetit, ashtu siç përcaktohet nga formula në Rregull, mund të ndikojë në rritjen e Fondit për BRE dhe, si rrjedhojë, të detyrimit për energjinë e ripërtërishme. Megjithatë, gjatë takimeve me institucionet financiare, ZRrE ka mësuar se alternativa më e favorshme, pra mbulimi i kostos së financimit të kapitalit punues, është e mundshme në tregun financiar në Kosovë.

Rezerva e likuiditetit aktivizohet vetëm në mungesë të këtyre instrumenteve financiare dhe duhet të caktohet në një nivel ruan kredibilitetin e OER si palë homologe në kontratat për BRE. Kjo është një kërkesë themelore për të siguruar bankabilitetin e skemës mbështetëse dhe për të ofruar siguri të mjaftueshme për investimet në sektorin e BRE, në përputhje me caqet shtetërore për BRE. ZRrE po ashtu pajtohet me shqetësimet lidhur me ndikimin në konsumatorët në nevojë dhe thekson përgjegjësinë ligjore të limituar të saj në këtë drejtim krahasuar me Ministrinë përgjegjëse për

¹ Koncept Dokumenti për Mekanizmin Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme i publikuar në faqen e ZRrE-së [https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Komunikatat/20250815_Koncept%20Dokument%20\(ZRrE\)%20\(1\).pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Komunikatat/20250815_Koncept%20Dokument%20(ZRrE)%20(1).pdf)

mirëqenie sociale. ZRrE nuk mund të komentojë krahasimin me mekanizmat përkatëse në Shqipëri e Maqedoni të Veriut, në mungesë të citimeve dhe të dhënave zyrtare lidhur me rezervat e likuiditetit në këto shtete. Vendimi i Këshillit të Ministrave për Operatorin e Energjisë së Ripërtërishme nuk specifikon madhësi, përqindje apo formulë specifike për likuiditetin apo rezervat e Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme².

4.1.4 Detyrimi i Energjisë së Ripërtërishme

Detyrimi për Energjinë e Ripërtërishme është në zbatim që nga themelimi i skemës së mbështetjes për BRE dhe i Fondit për BRE. Ligjit për BRE nuk lejon pezullimin apo mos-zbatimin e detyrimit, për aq kohë sa skema mbështetëse është aktive.

Sa i përket sistemit të Garancive të Origjinës (GO), Kosova tashmë është duke e funksionalizuar këtë sistem në përputhje me kërkesat ligjore. Që nga anëtarësimi i Kosovës në Shoqatën e Organizatave Lëshuese të Garancive të Origjinës (AIB), GO-të do të jenë të njohura ndërkombëtarisht, duke u harmonizuar me standardin Evropian EECS, që siguron transparencë të gjenerimit të energjisë së ripërtërishme.

Komenti lidhur me periudhën e raportimit për vetë-konsumatorët nuk trajtohet në këtë Rregull pasi që Mekanizmi nuk paragjykon kushtet e përfituara të palëve të cilat përfitojnë nga skemat mbështetëse përkatëse. Periudha e raportimit në këtë rregull vlen për obligimet e raportimit të furnizuesve tek OER në lidhje me detyrimet, bilanci dhe përfitimet e vetë-konsumatorëve.

4.2 Përgjegjësitë balancuese për vetë-konsumatorët

Ministria e Ekonomisë (ME) dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) kanë komentuar propozimin e ZRrE-së për metodologjinë e integritit të vetë-konsumatorëve në Kornizën Mbështetëse për BRE-të. Komenti kryesor i KOSTT është se vetë-konsumatorët nuk duhet të jenë pjesë e OER dhe posaçërisht që OER nuk duhet të jetë përgjegjës tepricat e energjisë të prodhuara nga ta. Ministria e Ekonomisë thekson se e tërë përgjegjësia e balancimit, dhe jo vetëm përgjegjësia për konsumin e energjisë së vetë-konsumuesve, duhet të i takojë furnizuesve nga të cilët shërbehen këta vetë-konsumatorë. Ky kapitull i Raportit adreson specifikisht këto komente të KOSTT dhe ME, që ndërlidhen me mënyrën e integritit të vetë-konsumatorëve në Mekanizmin Mbështetës. Komentet e tjera të KOSTT dhe ME trajtohen në Kapitujt 4.3 dhe 4.4 të Raportit.

4.2.1 Përfshirja e vetë-konsumatorëve në Mekanizmin Mbështetës

ZRrE potencon rëndësinë e përfshirjes së vetë-konsumatorëve me skema mbështetëse në Mekanizmin Mbështetës sipas nenit 30 të Ligjit për Promovimin e Energjisë së Ripërtërishme, si dhe sipas kontratave të trashëguara të skemave mbështetëse për vetë-konsumatorë (bazuar në Rregullën për vetë-konsumatorët me Burime të Ripërtërishme të vitit 2017 dhe 2023). Përfshirja e vetë-konsumatorëve në mekanizmin mbështetës është vegël për shmangien e shtrembërimeve në tregun e energjisë elektrike me pakicë dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së politikave rregullative në raport me kornizat mbështetëse të përfituara nga vetë-konsumatorët.

² [Qeveria Shqiptare Keshilli i Ministrave](#)

Vetë-konsumatorët, në veçanti ata që përfitojnë nga skema mbështetëse me neto-matje, nëse nuk adresohen me qartësi në dizajnin e kornizës mbështetëse, mund të krijojnë kosto shtesë që u ngarkohen padrejtësisht furnizuesve në treg të lirë. Duke qenë se furnizuesit mbajnë detyrim ligjor për të furnizuar vetë-konsumatorët, çdo politikë që nuk neutralizon kostot shtesë të furnizimit të këtyre vetë-konsumatorëve krijon shtrembërime të tregut dhe do përkeqëson pozitën konkurruese të furnizuesve në treg. Përfshirja e vetë-konsumatorëve në Mekanizmin Mbështetës siguron që kostot shtesë që ndërlidhen me furnizimin e këtyre konsumatorëve barten nga të gjithë akterët në treg në mënyrë jo-diskriminuese duke nivelizuar kushtet e furnizuesve për pjesëmarrje në treg.

ZRrE thekson rëndësinë e mirëmbajtjes së qëndrueshmërisë rregullatore dhe mbrojtjes së të drejtave që rrjedhin nga skemat ekzistuese të mbështetjes për kredibilitetin e politikave rregullative në sektorin e energjisë. Për të siguruar besueshmëri afatgjatë dhe për të mbrojtur bankabilitetin e investimeve ekzistuese, është e rëndësishme që ndryshimet në politikat shtetërore të mos ndikojnë negativisht në kontratat dhe të drejtat e fituara në kuadër të skemave mbështetëse. Kjo do të rezultonte në cenim të të drejtave që vetë-konsumatorët tashmë i gëzojnë në bazë të kontratave të tyre ekzistuese me neto-matje, duke krijuar pasiguri juridike dhe rrezik të devijimit nga parimet e qëndrueshmërisë së politikave rregullative. Përfshirja e vetë-konsumatorëve në Mekanizmin Mbështetës siguron të drejtat e përfituara nga vetë-konsumatorët nga skemat ekzistuese, duke ulur riskun rregullator dhe mirëmbajtur parashikueshmërinë e politikave rregullatore.

4.2.2 Baza ligjore për integrimin e vetë-konsumatorëve

KOSTT dhe ME kanë vënë në pikëpyetje pajtueshmërinë e propozimit të ZRrE me detyrimet që burojnë nga Ligji për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë. Pas shqyrtimit të komenteve, ZRrE konstaton se:

- ZRrE pajtohet me konstatimin e KOSTT për Nenin 28.2(5) të Ligjit për BRE që vetë-konsumatori ka të drejtë të *“lidhë një kontratë furnizimi me furnizuesin e vet, sipas një skeme mbështetëse të miratuar nga Rregullatori”*. Porse ZRrE thekson se ky koment nuk ka ndikuar në ndryshimin e propozimit të ZRrE-së pasi që – sipas propozimit të ZRrE-së – vetë-konsumatorët vazhdojnë të kenë kontrata të nënshkruara me furnizuesin e tyre siç kërkohet me nenin 30, paragrafi 1 të Ligjit për BRE. Pala tjetër e OER, sipas propozimit të ZRrE, nuk është vetë-konsumatori por është furnizuesi i tyre.
- ZRrE pajtohet se modeli i propozuar për ndarjen e përgjegjësisë balancuese për vetë-konsumatorin nuk është në linjë me interpretimin e Ministrisë së Ekonomisë të Nenit 30 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. ZRrE konsideron se propozimi për bartjen e përgjegjësisë së tepricave për OER është në linjë me frymën e përgjithshme të ligjit, duke përfshirë edhe kategoritë tjera të vetë-konsumatorëve siç janë (i) vetë-konsumatorët të vendosur në të njëjtën ndërtesë, duke përfshirë ndërtesat shumëbanesore dhe (ii) bashkësitë për energji nga burimet e ripërtërishme, duke siguruar qasje konsistente në mes të vetë-konsumatorëve dhe prodhuesve të pranuar në skema tjera mbështetëse.
- Draft Rregulli për Mekanizmin Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme, në përputhje me nenin 26, paragrafi 1, siguron që të drejtat e fituara sipas skemave mbështetëse për vetë-konsum nuk cenohen, dhe se vetë-konsumatorët nuk ndikohen

negativisht, përderisa një e drejtë e tillë është e fituar sipas legjislacionit në fuqi. Ligji për BRE, neni 3 paragrafi 39, parasheh që Fondi për Burime të Ripërtërishme të Energjisë të mbulojë kostot e skemave mbështetëse, e që në këtë rast përfshin edhe skemat mbështetëse me neto matje apo neto faturim të aprovuara me legjislacion dytësor nga ZRRE, respektivisht ZRRE/Rregulla Nr. 10/2017 dhe ZRRE/Rregulla Nr. 03/2023.

Për t'u siguruar që Mekanizmi Mbështetës siguron pajtueshmëri të plotë juridike, ZRRE propozon që përgjegjësinë e imbalancave t'ia alokojë furnizuesve të vetë-konsumatorëve, në pajtueshmëri të plotë me Nenin 30 të Ligjit. Ky ndryshim imponon disa ndryshime konceptuale në rregull, të cilat i sqarojmë në Kapitullin në vijim.

4.2.3 Kompensimi për vetë-konsumatorët


Ky nën-kapitull qartëson qasjen e kompensimit për koston e vetë-konsumatorëve. Në nën-kapitullin 4.2.3.1, sqarojmë kompensimin e propozuar nga ZRRE në koncept dokument dhe në Rregullin për Mekanizmin Mbështetës; Në nën-kapitullin 4.2.3.2 qartësojmë ndryshimet e nevojshme për të bartur përgjegjësinë e balancimit tek furnizuesit e vetë-konsumatorëve.

4.2.3.1 Kompensimi në draftin ekzistues i vetë-konsumatorëve

Sipas draftit ekzistues që i është nënshtruar konsultimit publik, kompensimi i vetë-konsumatorëve të pranuar në skemë mbështetëse funksionon si vijon:

- Vetë-konsumatorët nënshkruajnë kontratë me furnizuesin e tyre, i cili është përgjegjës për balancimin e konsumit të vetë-konsumatorëve;
- Furnizuesi i vetë-konsumatorit alokon tërë prodhimin shtesë të vetë-konsumatorëve tek OER i cili e shet këtë energji në tregun e ditës në avancë dhe bëhet përgjegjës për balancimin e prodhimit të vetë-konsumatorëve;
- Të ardhurat e OER nga shitja e kësaj energjie zbriten në Fondin për BRE dhe – rrjedhimisht – sjellin në ulje të Detyrimit për Energjinë e Ripërtërishme.
- OER e kompenson furnizuesin për kreditë e përdorura nga vetë-konsumatori.
- Furnizuesi e kompenson vetë-konsumatorin për kreditë e përdorura nga ai.

Figure 2 Kompensimi i vetë-konsumatorëve sipas draftit ekzistues



Përveç që siguron të drejtën e përfituar nga vetë-konsumatorët, skema e propozuar eliminon shtrembërimet në treg dhe vendosë linja të qarta të kompensimit në mes të shitjeve dhe blerjeve të energjisë pasi që pala përgjegjëse për alokimin e kësaj energjie në bursë është vetë OER. ZRrE pajtohet se një nga mangësitë e kësaj skeme qëndron në faktin se përgjegjësia balancuese ndahet në palë të ndryshme për konsum (furnizuesi) dhe prodhim (OER), gjë që mund të jetë subjekt i interpretimit ligjor.


4.2.3.2 Bartja e përgjegjësisë balancuese tek Furnizuesi i vetë-konsumatorit

Bartja e tërë përgjegjësisë balancues tek furnizuesi kërkon përcaktim të qartë rreth trajtimit të tepricave të injektuara nga vetë-konsumatori. Zgjidhja më e afërt ekuivalente me draftin ekzistues të vetë-konsumatorëve, por që reflekton kushtin e Nenit 30 të Ligjit për BRE, është që energjia teprice e vetë-konsumatorit të konsiderohet energji e shitur me vëllimet aktuale dhe çmimet e realizuara në tregun me shumicë. Kompensimi i vetë-konsumatorëve sipas kësaj skeme do të funksiononte si vijon:

- Vetë-konsumatorët nënshkruajnë kontratë me furnizuesin e tyre, i cili është përgjegjës për balancimin e konsumit dhe prodhimit të vetë-konsumatorëve;
- Furnizuesi e krediton vetë-konsumatorin për energjinë teprice në bazë të skemave mbështetëse (neto matje apo neto faturim) sipas rregullave të ZRRE.
- Furnizuesi zbaton kreditë e përdorura nga vetë-konsumatori në faturën e tij.

- OER kompenson furnizuesin e vetë-konsumatorit (apo anasjelltas) për dallimin në mes kredive të përdorura të vetë-konsumatorëve me skema mbështetëse (kostot e furnizuesit) dhe të ardhurave nga shitja e energjisë së tepricës së vetë-konsumatorit (përfitimet e furnizuesit).

Figure 3 Kompensimi i vetë-konsumatorëve kur palë përgjegjëse për balancim janë furnizuesit e tyre



Bartja e përgjegjësisë balancuese tek furnizuesit kërkon reflektim të të ardhurave nga shitja e tepricave të vetë-konsumatorit. OER kompenson furnizuesin për ndryshimin në mes të vlerës monetare të kredive të përdorura nga vetë-konsumatori dhe të hyrat nga shitjet e tepricave. Në këtë rast, të hyrat nga tepricat e vetë-konsumatorit llogariten si prodhimi në mes të vëllimit të energjisë tepricë të vetë-konsumatorit (kWh) dhe çmimit referent të bursës kombëtare të energjisë (ALPEX). Një nga mangësitë e këtij ndryshimi, në raport me draftin ekzistues, qëndron në faktin se kostoja e energjisë në treg, që lidhet me çmimin e tregut ALPEX, mund të ndryshojë nga mesatarja e ponderuar e kostos së energjisë me shumicë të furnizuesve, por se nuk ka arsye që këto ndryshime të jenë sistematike apo të njëanshme që do të mund të dëmtonin vetë-konsumatorët, furnizuesit apo OER. Për më tepër incentiva për shitje të energjisë tepricë në linjë me incentivat e tregut mbetet për furnizuesit, ashtu që të mos krijohen shtrembërime të tregut. Si rrjedhojë, duke vlerësuar përparësitë e këtij ndryshimi në përmirësimin e pajtueshmërisë ligjore, ZRrE propozon që përgjegjësia për balancim të bartet tek Furnizuesit, dhe jo tek OER, dhe që drafti i Rregullës të ndryshohet për të reflektuar këto ndryshime.

4.3 Komentet e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT)

Në këtë kapitull të Raportit adresohen komentet e tjera të KOSTT të cilat nuk kanë të bëjnë me përgjegjësinë balancuese të energjisë së vetë-konsumatorëve.

4.3.1 Kostot shtesë të KOSTT për menaxhimin e përgjegjësi të OER

ZRrE pajtohet se menaxhimi i përgjegjësi të zgjeruara të OER mund të ndikojë në rritje të kostove operacionale dhe të mirëmbajtjes, sidomos të atyre të teknologjisë informative. Këto kosto tashmë janë të parapara në formulën e propozuar nga ZRrE për kostot e lejueshme të Fondit për BRE. ZRrE do të punojë me KOSTT gjatë procesit të përcaktimit të kostove të Fondit për BRE për t'u siguruar që KOSTT të jetë në gjendje të mbulojë kostot e arsyeshme për menaxhimin efikas të Fondit.

4.3.2 Sfidat operacionale të menaxhimit të tepricave të energjisë

Sipas propozimit të ZRrE-së në Kapitullin 4.2.3.2 të këtij raporti, përgjegjësia për balancimin e tepricave të energjisë u takon furnizuesit të konsumatorëve. Megjithatë, përfitimet e furnizuesve nga shitja e tepricave të energjisë do të bartet në OER, por se kjo nuk pritet të paraqesë vështirësi shtesë në implementimin teknik të mekanizmit mbështetës.

4.3.3 Viti Relevant dhe llogaritja e Fondit BRE

Përkufizimi i Vitit Relevant është konsistent me të njëjtin përkufizim në Rregullin për Vendosjen e të Hyrave Maksimale të Lejuara për OST/OT. Në listën e përkufizimeve të Rregullës përcaktohet "Vit Përkatës" në Nenin 2.1.14 që do të thotë perioda prej 12 muajsh kalendarikë të njëpasnjëshëm midis Përshtatjeve të Rregullta (1 Prill - 31 Mars).

ZRrE nuk pajtohet me propozimin e KOSTT që llogaritja të jetë *'sa më afër që është e mundshme të barabarta'*. Llogaritja e Fondit për BRE ka ndikim direkt në Detyrimin e Energjisë së Ripërtërishme dhe ZRrE konsideron se kjo llogaritje duhet të jetë e saktë dhe të përditësohet në mënyrë sistematike për të paraqitur ndryshimet në koston e financimit të skemave mbështetëse.

4.4 ZRrE nuk mund të komentojë mbi sugjerimin e KOSTT se rregulla mbi ndarjen e informacionit të ndjeshëm komercial mes OER dhe Operatorit të Tregut (Neni 7) nuk mund të zbatohet pasi që KOSTT nuk ka ofruar ndonjë argument për pamundësinë e implementimit të këtij Neni. Komentet e Ministrisë së Ekonomisë (ME)

Në këtë kapitull të Raportit adresohen komentet e ME të cilat nuk kanë të bëjnë me përgjegjësinë balancuese të energjisë së vetë-konsumatorëve.

4.4.1 Qartësimi i kostove që ndërlidhen me skemat mbështetëse

ZRrE pajtohet në parim me sugjerimin e Ministrisë së Ekonomisë për qartësimin e skemave mbështetëse për BRE. Megjithatë ZRrE konsideron se nuk është në mandat të saj të përcaktojë se çfarë forma të tjera të skemave mbështetëse mund të përcaktohen nga Qeveria e Kosovës për përkrahjen e burimeve të ripërtërishme të energjisë. Rregulla për Mekanizmin Mbështetës për BRE ka për qëllim vendosjen e mekanizmit për mbulimin e kostove të skemave mbështetëse, dhe jo përcaktimin e këtyre skemave.

4.4.2 Harmonizimi me Ligjin për BRE

Ministria e Ekonomisë propozon që Nenin 12, Paragrafi 1.3 i Rregullës për Mekanizmin Mbështetës të harmonizohet me Nenin 3, Paragrafin 1.39 të Ligjit për Burimet e Ripërtërishme. ZRrE konsideron se këto dy Nene kanë qëllime të ndryshme. Përderisa Neni 12 i Rregullit flet specifikisht për grantet, donacionet dhe kontributet të cilat konsiderohen të ardhura të Fondit të BRE-ve, Neni 3 i Ligjit përmbledhë tërësinë e fondeve në kuadër të obligimeve të energjisë. Harmonizimi fjalë për fjalë me këtë Nen do të mund të sillte në numërim të dyfishtë të disa kategorive të kostove, të cilat janë të përfshira në Nenet 12.1.1 dhe 12.1.2 të Rregullës.

4.4.3 Borxhi i keq i OER

Për Ministrinë është i paqartë lejimi i borxhit të keq për OER. ZRrE konsideron se lejimi i një përqindjeje të borxhit të keq për OER është i nevojshëm për të mbuluar rrezikun që një pjesë e faturave të saj ndaj furnizuesve mund të mos mblidhen. Kjo bëhet veçanërisht relevante në kontekstin e tregut të energjisë në Kosovë, i cili ndodhet në fazat e hershme të liberalizimit dhe po hapet për furnizues të rinj që ende nuk kanë histori të qëndrueshme financiare.

Në linjë me praktikën e ZRrE-së për Furnizuesin me Shërbim Universal, niveli i lejuar i borxhit të keq do të përcaktohet nga ZRrE duke analizuar vështirësitë reale të mbledhjes së faturave nga OER dhe duke mirëmbajtur nxitjen e OER për të përmirësuar efikasitetin operativ të mbledhjes së faturave.

4.4.4 Përfshirja e kostove të financimit apo financiare

Rregullatori nuk e pranon ndryshimin sepse termi aktual “instrumenteve të tjera të financimit” është më i saktë dhe i kufizuar vetëm te mjetet që shërbejnë drejtpërdrejt për sigurimin e likuiditetit (kredi, overdraft, revolving credit line, factoring etj.), në përputhje me qëllimin e nenit 2, që është garantimi i pagesave në kohë ndaj prodhuesve të energjisë së ripërtërishme. Termi i propozuar “instrumenteve të tjera financiare” është shumë më i gjerë, mund të përfshijë instrumente që nuk lidhen drejtpërdrejt me financimin e likuiditetit dhe do të zgjeronte në mënyrë të panevojshme kostot që mund të kalohen te Fondi dhe, në fund, te paguesit e Detyrimit të Energjisë së Ripërtërishme.

Përdorimi i një termi më të gjerë (“instrumente financiare”) do të kërkonte gjithashtu një kornizë shumë më të detajuar rregullatore për menaxhimin e rrezikut dhe mbikëqyrjen e instrumenteve komplekse financiare, përtej mandatit ekzistues të Fondit Mbështetës. Prandaj, formulimi aktual konsiderohet i mjaftueshëm, më mbrojtës për konsumatorët dhe në përputhje me objektivin e nenit.